




REPublika e Kosovës REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No 01-1151/13
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 17-04-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.03.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-243\13, për zyrtarin e lartë z. Selatin Retkoceri, Zyrtar Kryesor Financiar ne Kompaninë Regjionale të Ujësjiellësit “Prishtina”, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka ber ndryshimet e kërkuara nga AKK-ja.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas identifikimit te rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-243/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Selatin Retkoceri, Zyrtar i Lartë Financiarë, në Kompaninë Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina”, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme te konfliktit te interesit, pasi qe ushtron edhe pozitën e personit te autorizuar dhe pronarit në një biznes privatë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.02.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Retkoceri, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar te takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes se ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Retkoceri, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm te interesit ne ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari ne fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Zyrtar i Lartë Financiarë, në Kompaninë Regjionale

Ujësjiellësi "Prishtina" dhe ka te regjistruar një biznes ku është pronarë dhe person i autorizuar mirëpo nuk ushtron aktivitetet.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se ne afat sa më të shpejtë do të bëjë ndryshimet dhe do ta autorizoj një person që ta udhëheqë biznesin e regjistruar, dhe do ta shmange çfarë do situatë që mund të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë me datën 08.03.2013, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bartur tek personi I besuar të drejtën e drejtimit të biznesit.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z.Selatin Retkoceri, Zyrtar i Lartë Financiarë, në Kompaninë Regjionale Ujësjiellësi "Prishtina".

Konstatohet se : zyrtari i lartë z. Selatin Retkoceri, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Dolap

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

